



Balkan Policy Institute
Str, Qamil Hoxha,
Nr.4/3 , Prishtinë, Kosovë
Tel / +381 (0)38 220 552
Cell/ +377 (0) 44 746 749
www.policyinstitute.eu

Seb Bytyçi, MPA, MES

DOKUMENT DISKUTIMI

Reforma e pushtetit lokal dhe zgjedhjet

Reforma e pushtetit lokal

Reforma e pushtetit lokal në Kosovë konsiderohet se ka filluar me krijimin e tri pilot-njësive komunale në vitin 2005. Ajo ka marrë hov me krijimin me shndërrimin e këtyre pilot-njësive në komuna dhe me miratimin e Pakos së Ahtisarit që parasheh krijimin e komunave të reja me shumicë serbe. Gjithashtu, ligji i ri për qeverisje lokale parasheh kompetenca më të mëdha për komunat. Reformat në sistemin zgjedhor po ashtu kanë rritur dinamizmin në nivel lokal, kryesisht përmes zgjedhjes së drejtpërdrejtë të kryetarëve të komunave.

Duke pasur para sysh rëndësinë e çështjes së pakicës serbe në jetën politike në Kosovë, reforma e pushtetit lokal është bërë sinonim me krijimin e komunave të reja. Edhe pse akomodimi i pakicës serbe në shtetin e pavarur të Kosovës është njëri nga qëllimet kryesore të reformës së pushtetit lokal, ajo përmban edhe aspekte tjera të rëndësishme për përfaqësim, demokraci dhe ofrim të shërbimeve publike. Gjithashtu, duhet të mos harrojmë se procesi nuk përfundon me krijimin e komunave të reja. Disa komuna janë të ndara etnikisht, dhe po ashtu ekzistojnë ndarje tjera (si sociale apo gjeografike) që ndikojnë në jetën politike. Të gjitha këto duhet të merren parasysh në dizajnimin e sistemit zgjedhor.

Zgjedhjet lokale

Sipas ligjit për zgjedhjet lokale ka dy palë zgjedhje në nivel komunash. Zgjedhjet për Kuvendet Komunale dhe zgjedhjet për Kryetarë të Komunave. Për të dy këto zgjedhje secila komunë përbën një zonë të vetme zgjedhore.

Për zgjedhjet për Kuvende Komunale këshilltarët zgjedhen drejtpërdrejtë nga votuesit përmes sistemit të përfaqësimit proporcional. Në secilën komunë përdoret sistemi i listave partiake (të cilat duhet të përmbajnë së paku 30% të kandidatëve nga gjinia tjetër). Listat janë të hapura dhe qytetarët mund të votojnë për një subjekt politik dhe një kandidat. Votat për subjektin politik llogariten si vota për bartësin e listës apo kandidatin e parë të atij subjekti politik.



Balkan Policy Institute
Str, Qamil Hoxha,
Nr.4/3 , Prishtinë, Kosovë
Tel / +381 (0)38 220 552
Cell/ +377 (0) 44 746 749
www.policyinstitute.eu

Ndarja e vendeve të këshilltarëve komunalë bëhet sipas metodës Sent Lagy (Sainte-Laguë). Formula për koeficientin është $V/(2u+1)$ ku V është numri total i votave të një subjekti politik, u është numri i ulëseve të ndara për atë subjekt politik (fillimisht zero). Cilido subjekt që e ka koeficientin më të lartë e merr ulësen e parë, pastaj prapë përsëritet kalkulimi deri në ndarjen e të gjitha ulëseve. Me fjalë tjera, numri i përgjithshëm i votave të fituara nga secili subjekt pjesëtohet me numra tek 1, 3, 5, 7, 9, 11 e kështu me radhë derisa të alokohen të gjitha ulëset. Ky sistem është modifikuar vetëm te aspekti i përfaqësimit gjinor. Në rast se nuk ka përfaqësim së paku 30% të gjinisë tjetër, atëherë kandidati i fundit që ka fituar ulëse zëvendësohet me një kandidat të gjinisë tjetër.

Për zgjedhjet për Kryetarë të Komunave përdoret sistemi mazhoritar me balotazh. Kryetari zgjedhet drejtpërdrejtë nga votuesit. Fituesi shpallet nëse një kandidat merr më shumë se 50% të votave (50% plus një). Në rast se asnjë kandidat nuk arrin këtë përqindje të votave, atëherë dy kandidatët me numrin më të madh të votave shkojnë në balotazh apo raundin e dytë të zgjedhjeve. Kandidati që fiton shumicën e votave në këtë raund zgjedhet kryetar komune.

Tabela 1.

Zgjedhjet	Për Kuvend komunal	Për Kryetar të komunës
Sistemi	Përfaqësim proporcional	Mazhoritar me balotazh
Listat	Gjysmë të hapura	Nuk aplikohet (NA)
Metoda e ndarjes së ulëseve	Sent Lagy	Nuk aplikohet (NA)
Prag për t'u futur në kuvend	Nuk ka	Nuk aplikohet (NA)
Kuota të obligueshme	Gjinore 30%	Nuk aplikohet (NA)



Balkan Policy Institute
Str, Qamil Hoxha,
Nr.4/3 , Prishtinë, Kosovë
Tel / +381 (0)38 220 552
Cell/+377 (0) 44 746 749
www.policyinstitute.eu

Çfarë sistemi zgjedhor?

Disa kriteret që duhet t'i plotësojë një sistem zgjedhor janë:

- Llogaridhënia
- Përfaqësimi
- Drejtësia
- Të drejtat e barabarta për votues
- Thjeshtësia
- Reflektimi i preferencave të qytetarëve

Parandalimi i konfliktit

Zgjedhjet janë faktorë që i shtojnë njerëzit të mobilizohen në baza etnike, sociale, fisnore, familjare apo gjeografike. Kjo mund të ndikojë në krijimin apo forcimin e ndasive shoqërore në vend. Në shoqëritë e ndara preferohet të ketë një sistem zgjedhor që promovon bashkëpunimin e jo ashpërsimin politik apo dhunën. Këto sisteme quhen sentripetaliste. Dy prej tyre janë kryesore: vota alternative (VA) dhe vota e vetme e transverueshme (VVT).

Sistemi VA është sistem mazhoritar. Në sistemin e votës alternative votuesi mund të votojë për më shumë se një kandidat duke i ranguar kandidatët e parapëlqyer. Ky pra është sistem preferencial që i shtyn garuesit të kërkojnë edhe vota të dyta e të treta jo domosdoshmërisht vetëm vota të para. Kjo çon drejt një politike më të moderuar dhe jo përjashtuese.

Sistemi VVT është sistem proporcional. Në këtë sistem votuesit i rangojnë kandidatët e tyre të preferuar. Numërimi bëhet përmes përcaktimit të një kuote dhe të gjithë kandidatët që e kalojnë atë kuotë automatikisht fitojnë ulëse. Kandidatët me numrin më të vogël të votave të preferencës së parë eliminohen. Votat tepërcë redistribuohen tek kandidatët tjerë.

Këto dy sisteme njihen si sisteme preferenciale. Ato promovojnë “grumbullimin” e votave nga kandidatët nga votues të që i takojnë anëve të ndryshme të spektrit



Balkan Policy Institute
Str, Qamil Hoxha,
Nr.4/3 , Prishtinë, Kosovë
Tel / +381 (0)38 220 552
Cell/ +377 (0) 44 746 749
www.policyinstitute.eu

politik dhe etnive të ndryshme. Kjo çon drejt një politike jokonfrontuese mes kandidatëve.

Nëse ka më shumë zona zgjedhore mund të bëhet edhe “grumbullimi” i zonave. Këtu kandidatëve u kërkohet që të fitojnë një përqindje të caktuar të votave në më shumë se një zonë. Kjo garanton përfaqësim më të gjerë gjeografik.

Çështje për diskutim

Në bazë të këtij shtjellimi më lartë ne ngrisim disa pyetje për diskutim:

- A duhet të shkojë më tutje reforma e pushtetit lokal duke krijuar bashkitë për qytete si njësi administrative të veçanta?
- A duhet të krijohen më shumë zona zgjedhore brenda komunave?
- A do të duhej që këto zona të ishin një-anëtarëshe apo shumë-anëtarëshe?
- A duhet të hapen listat për kuvende komunale plotësisht, ku nuk duhet të votojmë patjetër për bartësin e listës?
- A duhet të kemi kuota për përkrahje gjeografike të kandidatëve?
- A duhet të instalojmë sistemet preferenciale zgjedhore për të parandaluar tensionimin politik dhe ndasitë?